

Screening per la prevenzione del tumore del collo dell'utero

SCREENING PËR PARANDALIMIN E TUMORIT TË QAFËS SË MITRËS





Çfarë është tumori i qafës së mitrës?

Është një tumor që ka mundësi të parandalohet dhe që shkaktohet nga disa lloje të papillomavirusit njerëzor (HPV)

Çfarë mund të bëjmë për të parandaluar tumorin e qafës së mitrës?

Mund të marrim pjesë në screening (analizën), që është një program pa pagesë për parandalimin e tumoreve për gratë e moshës nga 25 deri në 64 vjeç.

Nëse je më pak se vjeç, analiza screening është Pap-testi çdo 3 vjet.

Nëse je më shumë se vjeç, analiza screening është testi për kërkimin e HPV-së çdo 5 vjet.

Si bëhen këto analiza?

Si për Pap-testin ashtu edhe për testin e HPV-së, obstetri ose mjeku marrin një sasi të vogël të materialit nga qafa e mitrës. Marrja e materialit është e thjeshtë, pa dhimbje dhe zgjat disa minuta.

Pse duhet t'i bëjmë këto analiza edhe në qoftë se jemi mirë me shëndet?

Sepse ky tumor dhe dëmtimet që e paraprijnë nuk japin shqetësime gjithmonë.

Testi screening jep mundësinë e parandalimit të tumorit të qafës së mitrës ose mundëson zbulimin e tij në fazën fillestare.

Çfarë është papillomavirusi i njeriut (HPV)?

HPV është një virus që shkakton një infeksion shumë të zakonshëm në popullatë, por në shumicën e grave ai zhduket spontanisht pas një ose dy vjetësh.

Në disa raste infeksioni vazhdon dhe mund të shkaktojë dëmtime, të cilat, nëse nuk kurohen, mund të shndërrohen dalëngadalë në një tumor.

Çfarë ndodh pasi të bëjmë testin screening?

Nëse testi screening është normal ose nuk parashikon thellime të menjëhershme, do ta merrni përgjigjen në shtëpi dhe do t'ju kërkohet të përsërisni testin në kohën e caktuar.

Nëse testi screening është anormal dhe kërkon thellime të mëtejshme, do të kontaktoheni direkt për një takim.

Sa duhet të paguaj?

Testet e kontrollit dhe i gjithë procesi i diagnostikimit dhe kurave janë pa pagesë.

Nëse bëj një screening a mund të jem e qetë?

Screening, nëse bëhet rregullisht dhe duke ndjekur udhëzimet sipas programit, është mjeti më efektiv për të parandaluar tumorin e qafës së mitrës.

Megjithatë, si çdo analizë, testet screening paraqesin disa limite e nuk mund të zbulojnë sëmundje të tjera gjinekologjike.

Për informacione të mëtejshme në lidhje me infeksionin nga papillomavirus dhe screening me test HPV, mund të konsultoni "Le 100 domande sull'HPV" (100 pyetje për HPV-në) në faqen e internetit www.osservatorionazionale screening.it ose www.gisci.it.

Gruppo di lavoro


Anna Iossa e Francesca Maria Carozzi (Coordinatori), Angela Brachini, Cinzia Campari, Debora Canuti, Paola Capparucci, Francesca Maria Carozzi, Carmelina Di Piero, Chiara Fedato, Grazia Grazzini, Anna Iossa, Gessica Martello, Cristina Nicolai, Antonella Pellegrini.

Un ringraziamento particolare alle donne che hanno contribuito alla realizzazione di questo progetto:

Cloè Belliot, Lorena Baboçi, Magdalena Ciupercovici, Elise Merrill Chapin, Elena Dascaluc, Ekaterina Egorchenkova, Anna Garasymiv, María Maestre Fernández, Wendy Martin, Eshraga Mohammed Abdalwahap, Meriem Moutiai, Julia Nico e Natascha Pleshca.

Un ringraziamento al gruppo di lavoro delle 100 domande sull'HPV:

Debora Canuti, Francesca Maria Carozzi, Carla Cogo, Annarosa Del Mistro, Carmelina Di Piero, Silvia Franceschi, Cristina Giambi, Paolo Giorgi Rossi, Anna Iossa, Tiziano Maggino, Gessica Martello, Maria Grazia Pascucci.

**Realizzazione editoriale:**

Inferenze Scarl, Milano

La traduzione dall'italiano alle altre lingue è stata realizzata da:

STUDIO TRE S.r.l., Reggio Emilia

Progetto grafico e impaginazione:

Giovanna Smiriglia (Studio Impronte - Milano)